

**UNIVERSITETI I PRISHTINËS  
“HASAN PRISHTINA”  
FAKULTETI EKONOMIK**



**LËNDA:**

**MIKROEKONOMIA**

**Kapitulli 3: Elasticiteti i kërkesës dhe ofertës**

**Asistent: Msc. Neshat PODVORICA**

**Web faqe: [ekonomiks.weebly.com](http://ekonomiks.weebly.com)**

**E-mail: [neshat.podvorica@uni-pr.edu](mailto:neshat.podvorica@uni-pr.edu)**

**Tetor, 2019**

# Çka është elasticiteti?


- Elasticiteti shpreh shkallën e reagimit të konsumatorëve dhe prodhuesve ndaj ndryshimit të kushteve ekonomike të tregut, siç janë ndryshimet në çmimet e të mirave, të ardhurave të konsumatorit, të mirave plotësuese e zëvendësuese, etj.
- Pra, **tregon se sa është reagimi i blerësit apo shitësit ndaj një ndryshimi në çmimin e atij produkti.**

# Elasticiteti i kërkesës lidhur me çmimin


- Në bazë të ligjit të kërkesës thuhet se: me rastin e rritjes së çmimit zvogëlohet kërkesa.
- Por, ky ligj nuk na tregon se sa ndryshon.
- Prandaj, elasticiteti tregon se çfarë ndryshimi kemi në rast të ndryshimit të çmimit.
- Kemi kurbë të kërkesës **elastike** dhe kurbë të kërkesës **jo elastike**.

# Llojet e kurbës elastike dhe jo elastike

Kurba pjesërisht jo elastike



Kurba pjesërisht elastike



# Llogaritja e elasticitetit

- Përqindja e ndryshimit të sasisë shprehet me formulën:  $Q = \left\{ \frac{q_2 - q_1}{(q_2 + q_1)/2} \right\} \times 100$

- Përqindja e ndryshimit të çmimit shprehet:  $P = \left\{ \frac{p_2 - p_1}{(p_2 + p_1)/2} \right\} \times 100$

- Elasticiteti i kërkesës lidhur me çmimin:

$$E_d = \frac{\left\{ \frac{q_2 - q_1}{(q_2 + q_1)/2} \right\}}{\left\{ \frac{p_2 - p_1}{(p_2 + p_1)/2} \right\}} = \frac{\Delta q}{q^-} : \frac{\Delta p}{p^-} = \frac{\Delta q}{\Delta p} \times \frac{p^-}{q^-}$$

# Llogaritja e elasticitetit

- Nëse sasia e shitur ka qenë 200 njësi me çmim prej 5 € dhe nëse për shkak të ngritjes së çmimit për 1 € sasia e shitur e produkteve ka rënë në 160 njësi.
- Gjeni:  $Q1=$  \_\_,  $Q2=$  \_\_,  $P1=$  \_\_,  $P2=$  \_\_, dhe llogarit sa është elasticiteti i kërkesës lidhur me çmimin?

# Llogaritja e elasticitetit

- Vlera që del nga formula e elasticitetit paraqet: **Koeficientin e elasticitetit**
- Nëse koeficienti më i madh se 1 kërkesa është elastike,  $E_d > 1$ ;
- Dhe, nëse është më i vogël se 1 kërkesa është jo elastike,  $E_d < 1$  .

# Llogaritja e elasticitetit

- **Shembull 1.** Firma X shet 2500 produkte me çmim 5 € për njësi, dhe nëse çmimi rritet për 2 € atëher shitet do të zvogëlohen për 600 njësi. Gjeje elasticitetin e kërkesës lidhur me çmimin?
- **Shembull 2.** Nëse unë shes 1000 kafe në ditë me çmim prej 1€, unë dua ta ngris çmimin e kafes për 20%, pas konsultës që pata me ty, si ekonomisti më i mirë që jeni, më thatë që kërkesa për kafe do zvogëlohet për 50 njësi.
- Gjeje sa është elasticiteti i kërkesës lidhur me çmimin?



# Rastet ekstreme: Oferta me joelasticitet të plotë



**A: Perfectly Inelastic Supply**

- Kur oferta është me joelasticitet të plotë, sasia e ofruar është e njëjtë në secilin nivel të cmimit, kështu që elasticiteti i ofertës ndaj cmimit është zero.

# Rastet ekstreme: oferta me elasticitet të plotë



**B: Perfectly Elastic Supply**

- Kur oferta është me elasticitet të plotë, sasia e ofruar e është e ndjeshme ndaj ndryshimeve në cmim deri në pakufi, kështu që elasticiteti i ofertës ndaj çmimit është i pakufi.

# Faktorët që përcaktojnë elasticitetin e kërkesës lidhur me çmimin

- ***Ekzistenca e të mirave zëvendësuese***

Kur për një të mirë ekzistojnë të mira zëvendësuese, konsumatorët do të ketë një reagim të madh në qoftë se çmimet e ndonjërës prej tyre ndryshojn.

- Për të mirat që nuk kanë zëvendësues, kërkesa është joelastike, sepse konsumatori është i detyruar të vazhdojë të konsumojë të njëjtën të mirë, edhe kur çmimi i saj rritet.

- **Përcaktimi i të mirës**

# Faktorët që përcaktojnë elasticitetin e kërkesës lidhur me çmimin

- **Efekt i të ardhurave** – Me rritjen e të ardhurave rritet edhe kërkesa.
- **Faktori kohë**- Për periudha të shkurta kohe kërkesa ka tendencë të jetë joelastike ndaj ndryshimit të çmimit, ndërsa në periudha afatgjata ajo është shumë më elastike.
- **Të mirat e domosdoshme dhe të luksit- vështirë të ndahet në mes veti**

# Elasticiteti i kërkesës lidhur me të ardhurat

- Mat reagimin e kërkesës ndaj ndryshimit të të ardhurave, dhe shprehet:

$$\left\{ \frac{q_2 - q_1}{(q_2 + q_1) / 2} \right\}$$

- $E_y = \text{-----}$

$$\left\{ \frac{y_2 - y_1}{(y_2 + y_1) / 2} \right\}$$

**Shenja (+) e mirë normale, (-) inferiore**

**Ndikimi i të ardhurave në tre llojet e të mirave:**

Normale, Luksit dhe inferiore.

# Elasticiteti i tërthortë i kërkesës

- Mat reagimin e kërkesës së konsumatorit për të mirën **A** kur kemi ndryshim në çmimin e të mirës **B**.

$$\{(q_2 - q_1)a / (q_2 + q_1)a / 2\}$$

- $E_{a,b} = \text{-----}$

$$\{(p_2 - p_1)b / (p_2 + p_1)b / 2\}$$

- **Shembull:** Ne konsumojmë 10 molla nëse çmimi i dardhave është 2€, nëse ngritet çmimi i dardhave për 1€ ne do të ngrënim 20 molla, gjeje elasticitetin e tërthortë të kërkesës?

# Elasticiteti i tërthortë i kërkesës

- Kur koeficienti **më i madhë se 1** të mirat janë shumë të lidhura për njëra tjetrën dhe anasjelltas.
- Kur koeficienti (+) blejmë më shumë nga ky produkt nëse çmimi i produktit tjetër rritet dhe e kundërta kur është (-) do blejmë më shumë kur çmimi tjetër zvogëlohet.
- Pra, kur (+) zëvendësuese, (-) plotësuese

# Elasticiteti i ofertës lidhur me çmimin

- Tregon reagimin e shitësve ndaj një ndryshimi në çmim.

$$\{(q_2 - q_1) / (q_2 + q_1) / 2\}$$

- $E_s = \text{-----}$

$$\{(p_2 - p_1) / (p_2 + p_1) / 2\}$$

- Kur koeficienti më i madhë se 1 oferta është elastike, dhe më i vogël se 1 nuk është elastike.



# Faktorët që ndikojnë te elasticiteti i ofertës

1. Kostoja dhe mundësia për t'u depozituar produktet;
2. Fleksibiliteti i prodhimit;
3. Kostoja e prodhimit të njërive shtesë;
4. Faktori kohë.

**Ju faleminderit!**